

DHJETOR 2020 | BULETINI NO. 1

BULETINI I RIMËKËMBJES

ÇFARË ËSHTË BULETINI
I RIMËKËMBJES?

**Pakoja e Rimëkëmbjes:
Synimet dhe pritjet - 2**

Statusi i implementimi- 7

BULETINI I RIMËKËMBJES

është pjesë e projektit “Barometri i Rimëkëmbjes – për transparencë dhe llogaridhënie”. Qëllimi kryesor i këtij buletini është që t’ju ofrojë informata të përmbledhura hisedarëve kryesorë, qytetarëve dhe publikut të gjerë në lidhje me statusin e zbatimit të masave të Rimëkëmbjes, të dhënat rreth synimeve dhe pritjeve të Pakos së Rimëkëmbjes si dhe përfituesve kryesorë të këtyre masave. Këto informata do të trajtohen në detaje edhe në buletinet e rradhës.

Në këtë buletin mund të gjeni një përshkrim të detajuar të masave të ndërmarra nga institucionet e Republikës së Kosovës. Këto masa kanë për qëllim zvogëlimin e ndikimeve negative që ka shkaktuar pandemia në ekonominë e Kosovës, si dhe mundësitë e rialokimit të resurseve dhe mundësisë së stimulimit të ngritjes së aktiviteteve ekonomike.

PAKOJA E RIMËKËMBJES – SYNIMET DHE PRITJET

Si rezultat i pandemisë, kriza ekonomike dhe ajo shëndetsore ka kapluar pothuajse të gjitha shtetet e botës. Në këtë krizë ekonomike është duke kaluar edhe vendi ynë. Duke u nisur nga ky problem, sikurse shumë shtete të tjera të botës të cilat kanë hartuar Pakot e Rimëkëmbjes Ekonomike, edhe vendi ynë së fundi ka miratuar Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike me qëllim të mbështetjes së Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike.

”

RRETH 212 MILION EURO DO TË JENË
NË DISPOZICION PËR QYTETARËT E
KOSOVËS NGA TRUSTI PENSIONAL,
PA PAGUAR TATIM PËR TËRHEQJEN E
KËTYRE MJETEVE.

“

”


QËLLIMI I KËTIJ LIGJI ËSHTË
PLOTËSIMI DHE NDRYSHIMI I DISA
LIGJEVE TË TJERA, KJO ME QËLLIM TË
RIMËKËMBJES SË EKONOMISË SË
KOSOVËS, PAS EFEKTEVE NEGATIVE
QË I KA SHKAKTUARA PANDEMIA
COVID -19 GJATË VITIT 2020.

“

Përkrahja e qytetarëve të Kosovës përmes Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike do të bëhet në disa mënyra. Si rezultat i pandemisë shumë biznese kanë falimentuar e shumë të tjera kanë zvogëluar numrin e punëtorëve, prandaj kjo përkrahje ka për qëllim revitalizimin e ekonomisë,

Në kuadër të këtij ligji, përfituesit kryesor do të jenë vet qytetarët e Kosovës. Si pikë e parë e cila ka filluar të zbatohet me miratimin e këtij Ligji është mundësia e tërheqjes së 10% të kursimeve pensionale nga Fondi Pensional i Kosovës. Përmes plotësim/ndryshimit të Ligjit për Fondin Pensional të Kosovës, qytetarët do të kenë mundësi që brenda 4 muajve të tërheqin mjetet e tyre.

Për qytetarët të cilët kanë kursime deri në shumën 9,999€, këto mjete do ju rimbursohen duke filluar nga viti 2023 nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Procedura e tërheqjes së këtyre mjeteve do jetë mjaft e thjeshtë dhe lehtë e aplikueshme. Aplikimi për tërheqjen e këtyre mjeteve do jetë në mënyrë elektronike. Ky aplikim mund të bëhet përmes faqes: <https://www.trusti10.org/>



Në kuadër të Rimëkëmbjes Ekonomike, përmes këtij Ligji janë bërë plotësime dhe ndryshime edhe në Ligjin Nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Përmes këtij plotësime ndryshimi, ky fond autorizohet që të lëshojë garanci kreditore me përqindje të mbulesës deri në 80%. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore do të lëshojë garanci në kredi me destinim zhvillimin e biznesit për fermerët e regjistruar në mënyrë të rregullt në regjistrin e fermerëve të cilët janë të pajisur me Numër Identifikues të Fermës, edhe në ato rastet kur fermeri nuk ka regjistruar shoqëri tregtare në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës.

Sa i përket mbështetjes së sektorit të bujqësisë, përmes këtij ligji përcaktohet se lënda e parë që prodhohet në Kosovë, do jetë e liruar nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH). Ky lirim nga TVSH vlenë për të gjitha lëndët e para të cilat prodhohen në Kosovë nga veprimtaritë biznesore të cilat janë aktive në Kosovë si dhe janë të regjistruara.

Në kuadër të mbështetjes së Rimëkëmbjes Ekonomike, Qeveria e Kosovës ka paraparë edhe plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurave. Përmes tij, lirohen nga interesi tatimpaguesit që kanë obligime tatimore të papaguara të cilat kanë ndodhur gjatë periudhës 01.01.2020 dhe 31.12.2020. Këto obligime tatimore, tatimpaguesit duhet të i paguajnë gjatë kësaj periudhe, në mënyrë që të mund të lirohen nga interesi ndaj këtyre obligimeve tatimore.



Sesa do të ndihmojë Pakoja e Rimëkëmbjes vendin e ilustron më së miri fakti se vetëm brenda 5 ditëve pas hapjes së faqes për aplikim online, janë më shumë se 50% të qytetarëve të cilët kanë aplikuar për marrjen e 10%.




Preferencë do të kenë gjithashtu edhe ofertuesit vendorë dhe shërbimet vendore edhe në raste kur kriter i kontratës është çmimi më i ulët. Në këto raste përparësi do të kenë gjithashtu prodhuesit dhe shërbimet vendore. Kjo përkrahje do të jetë deri në rastin kur çmimet e ofertuesit të produkteve dhe shërbimeve vendore të jenë jo më të larta se 15% përqind sesa ato të huaja.



Nisur nga fakti se sektori privat gjatë kësaj periudhe ka pësuar mjaft dëmtime dhe se shumë biznese janë detyruar që të mbyllën ose u është rrezikuar mbyllja, shumë punonjës janë pezulluar ose edhe larguar nga vendet e tyre të punës. Për këtë shkak, përmes këtij ligji këtyre punonjësve do t'ju mundësohet që në periudha jo më të shkurta se 3 muaj t'ju paguhen pagat e tyre. Kjo shumë e pagave të cilat do 'u ofrohen punonjësve do të jenë 300 euro për 1 muaj.

Në mënyrë që të përkrahen prodhuesit e produkteve dhe shërbimeve vendore, përmes këtij ligji janë përcaktuar edhe përparësitë që do t'i kenë ata. Këto përparësi do u jepen prodhuesve vendorë dhe shërbimeve vendore gjatë vlerësimit të ofertave, ku prodhuesit dhe shërbimet vendore do ju jepet përparësi krahas ofertave të ofertuesve të huaj.






Përparësi në Pakon e Rimëkëmbjes
Ekonomike ju është
dhënë edhe subjekteve të cilat paguajnë
Rentën Minerare. Përmes Ligjit Për
Rimëkëmbje Ekonomike, këto subjekte
janë të liruara nga pagesa e rentës
minerare
duke filluar nga data **01.01.2021** deri në
datën **31.05.2021**. Duke u bazuar në
raportin vjetor të Komisionit të Pavarur
për Miniera dhe Minerale, kjo pagesë
gjatë vitit 2019 ka qenë rreth
29,385,154.20 €.

**Kjo tabelë tregon
nivelin e inkasimit të
rentës minerare për
vitet e paraqitura!**

Përfituesi më i madh në lirimin nga
rënta minerare do jetë Koorporata
Energjetike e Kosovës. Ky lirim nga kjo
pagesë do motivojë subjektet që të
ndihmojnë në rimëkëmbjen
ekonomike përmes ngritjes së
kapaciteteve të
prodhimit dhe në këtë mënyrë do të
ndikojë në mënyrë indirekte në rritjen
e vendeve të punës dhe në
rimëkëmbjen ekonomike.



STATUSI I IMPLEMENTIMIT



- 212 mil.€ nga Trusti PENSIONAL

- 200 mil.€ përkrahje për bizneset

- 20 mil.€ për punëtorët që kanë humbur vendet e punës

- 0% TVSH për lëndën e parë të prodhuar në vend

- 0% interes dhe ndëshkime për bizneset që janë vonuar

- ulja e TVSH nga 18% në 8% për hotele, restorante dhe

- 80% e kolateralit të kredive për biznese mbulohet nga

- 0% rentë minerare dhe tarifë për energjinë e ripertrish

- Përparësi për prodhues vendorë në kontrata publike

- Përparësi për ofertues vendorë në kontrata publike

Ky buletin është përgatitur me mbështetjen e
Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).

Pikëpamjet e shprehura në këtë buletin janë të INDEP dhe në asnjë
mënyrë nuk mund të konsiderohen si qëndrim i Fondacionit të Kosovës
për Shoqëri të Hapur (KFOS).